

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANË
NOTERE ANISA G. DIZDARI
NR. 808 REP.
NR. 70/1 KOL.



AKT THEMELIMI

“UNIVERSE” Sh.A.

Sot më datë 09/05/2017 (Dymijë e shtatëmbëdhjetë) në Tiranë para meje Notere ANISA G. DIZDARI, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me Liçensë Nr.238, me NIPT L31925014A, që ushtror aktivitetin në studion e ndodhur në adresën Rr. “Dibrës”, Nr.277, Tiranë u paraqitën palët e mëposhtëm:

1. **MAREN Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me NIPT K81318518N, me seli në Lagjia Nr. 13, Pallati “Mark Jakova, Durrës, Shqipëri, (këtej e tutje e quajtur “MAREN”), përfaqësuar nga Z. Ilir Hasanbelli, shtetas shqiptar, lindur në Durrës më 08.04.1970, banues në Durrës, Shqipëri, me Nr. Pasaporte: H00408169S;
2. **Universal Software Solutions N.V.**, një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Curaçao, me seli në E-Commerce Park Vrenderberg, P.O Box 422 (këtej e tutje referuar si “USS”) përfaqësuar nga Z. Ulas Utku Bozdogan, shtetas turk, lindur në Ankara, Turqi, më 30.08.1980, banues në Rr. “Kodra e Diellit”, Tiranë, Shqipëri, me numër pasaporte U12984483, sipas Prokurës së Përgjithshme datë 4 Prill 2017.

të cilët në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të krijojnë një shoqëri aksionere pa ofertë publike, të emërtuar “Universe” Sh.A (në vijim referuar si “Shoqëria”) me anë të nënshkrimit të këtij Akti Themelimi. Shoqëria do të kryejë sipas ligjeve shqiptare dhe Statutit të saj, i cili është pjesë thelbësore e këtij Akti Themelimi.

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

Shoqëria emërtohet “Universe” Sh.A.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e shoqërisë është në Lagjia Nr. 13, Rruga e Palmave, Ndërtesa Nr. 4, Hyrja 10, Ap. 1, Durrës, Shqipëri.



- 2.2 Shoqëria e kryen aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Këshilli Mbikqyrës mund të krijojë dhe/ose mbyllë degë, agjenci apo zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4 Objekti

Shoqëria ka si objekt të saj kryerjen e veprimtarive në të gjitha fushat e ndërtimit, transportit, reklamave, lojrave të fatit, import, eksport, hoteleri, turizëm, loja elektronike në distancë, call center, teknologji informacioni, shërbime kompjuterike, marketing, krijimi dhe menaxhimi i web sites, shërbim design webi, programime kompjuterike dhe elektronike, regjistrim domain-esh, prodhim dhe përpunim tekstilësh, fabrikim në industrinë e veshjeve ,dizenjime, bar, restorant, aktivitete financiare, aktivitet në këmbim valutor, evente të ndryshme, telekomunikacion, media dixhitale, produksion, tregti me shumicë dhe pakicë.

Gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e Shoqërisë të lëshuara nga organet kompetente, Shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.

Neni 5 Kapitali aksionar i Shoqërisë – Kontributet

Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme.

- 5.2 Secili aksionar mund të zotërojë më shumë se një aksion. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.
- 5.3 Aksionarët kanë nënshkruar plotësisht aksionet, në përputhje me Ligjin Shqiptar për shoqëritë tregtare, si më poshtë:
- a) Maren Shpk, e cila ka kontribuar në natyrë, në pasuri të paluajtshme, në kapitalin aksionar të Shoqërisë me një vlerë të barabartë prej 840,000,000 (tetëqind e dyzet milion) Lekë, vlerësuar nga ana e ekspertit i licensuar të caktuar me Vendimin Nr. 11-2017-1732 (572), datë 10 Prill 2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
 - b) Universal Software Solutions N.V., e cila ka kontribuar në para në kapitalin aksionar të Shoqërisë me një vlerë të barabartë prej 360,000,000 (treqind e gjashtëdhjetë milion) Lekë.
- 5.4 Në bazë të kontributeve të sipërpërmendura, në çastin e themelimit:

- IKAE SHQIP
- a) MAREN shpk, zotëron 7,000 (shtatë mijë) aksione me vlerë totale prej 840,000,000 Lek (tetëqind e dyzet milion Lek) që i korrespondojnë 70 % (shtatëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
 - b) Universal Software Solutions N.V, zotëron 3,000 (tre mijë) aksione me vlerë totale prej 360,000,000 (treqind e gjashtëdhjetë milion Lek) që i korrespondojnë 30 % (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

5.5 Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila vërteton titullin e pronësisë mbi aksionet me shpenzimet e aksionarit të interesuar. Kjo certifikatë nuk ka funksionin e një letre me vlerë. Certifikata duhet të lëshohet në emër të aksionarit të interesuar. Vendimi për lëshimin e certifikatës merret nga Asambleja e Përgjithshme. Forma dhe përmbajtja e certifikatës së aksionit përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikqyrës në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Transferimi i aksioneve

Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen tërësisht apo pjesërisht në bazë të procedurës së përcaktuar në nënin 9 të Statutit.

Neni 7

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme,
- Këshilli Mbikqyrës dhe
- Administratorët.

Neni 8

Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

- 8.1 Shoqëria drejtohet dhe mbikqyret nga Këshilli Mbikqyrës i përbërë prej 3 anëtarësh. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës nuk mund të jetë më i gjatë se 3 (tre) vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të rizgjidhen.
- 8.2 Personat e mëposhtëm emërohen Anëtarë të Këshillit të Parë Mbikqyrës për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh:
 1. Ibrahim Aktas, shtetas turk lindur më datë 17.11.1985 në Pulumur, Turqi, banues në Tiranë, Shqipëri.
 2. Raci Genc, shtetas turk, lindur më datë 27.05.1979 në Ankara, Turqi, banues në Tiranë, Shqipëri.

3. Ekin Genc, shtetase turke, lindur më datë 12.10.1984 Altindag, Turqi, banues në Tiranë, Shqipëri.

Neni 9

Përbërja dhe emërimi i Administratorëve

- 9.1** Vendimet e përditshme të administrimit të Shoqërisë merren nga Administratorët. Cdo Administrator i zgjedhur dhe emëruar nga Këshilli Mbikqyrës mund të shkarkohet në cdo kohë me vendim të Këshillit Mbikqyrës. Vende vakante të krijuara në cdo pozicion në Shoqëri plotësohen nga Këshilli Mbikqyrës.
- 9.2** Administratorë mund të jetë 1 (një) apo më shumë persona fizikë të emeruar për një afat 3 (tre) vjecar dhe mund të rizgjidhen.
- 9.3** Personat e mëposhtëm janë Administratorët e parë të Shoqërisë për një periushë 3 (tre) vjecare:
- 1. Ulas Utku Bozdogan**, shtetas turk, lindur më datë 30.08.1980 në Ankara, Turqi, banues në banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës Nr. U12984483.
 - 2. Dritan Jeminaj**, shtetas shqiptar, lindur më datë 14.07.1983 në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës: BD3758506.

Neni 10

Kontabiliteti

Shoqëria mban bilance dhe përgatit pasqyra financiare të përshtatshme për të paraqitur në mënyrë të saktë gjendjen e saj financiare në përputhje me parimet e konsoliduara të kontabilitetit. Bilancet dhe pasqyrat financiare do të përputhen në formë dhe përmbajtje me standardet e kontabilitetit sic parashikohet nga ligji i zbatueshëm dhe nga rregullat e parimet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 11

Eksperti kontabël i Autorizuar

Asambleja e Aksionarëve emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të pavarur të cilët të jenë ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjit.

Neni 12

Gjuha

Ky Akt themelimi hartohet në 8 kopje, 4 (katër) në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) në gjuhën angleze. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Akti Themelimi, version në gjuhën shqipe do të mbizotërojë dhe do të jetë i vetmi me fuqi ligjore.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

Për ato çështje që nuk parashikohen në mënyrë të vecantë në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet ligji shqiptar për shoqëritë tregtare.

Administratorët e shoqërisë z.Ulas Utku Bozdogan dhe /ose z.Dritan Jeminaj autorizohen të regjistrojnë shoqërinë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Përsa më sipër u redaktua nga unë Noteria bazuar në nenet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në 8 (tetë) ekzemplarë, 4 (katër) në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) angleze me vlera të njëjta juridike, iu lexua me zë të lartë palëve dhe meqënëse e gjetën sipas vullnetit të lirë dhe të plotë të tyre e nënshkruan atë përpara meje dhe unë Noteria e vërtetoj në bazë të Ligjit Nr.7829, datë 01.06.1994 i ndryshuar "Për Noterinë" në Republikën e Shqipërisë.

Ortakët themelues

MAREN SH.P.K.

Ilir Hasambelli



UNIVERSAL SOFTWARE SOLUTIONS N.V

Përfaqësuar nga Ulas Utku Bozdogan

Ulas Utku Bozdogan

NOTERE
ANISA G. DIZDARI

Anisa G. Dizdari

